



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
Nr. 03-370
24.11.2023
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 14 paragrafi (1) të Ligjit për media („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13 dhe 13/14), pika 3 nënparagrafi 2 dhe pika 14 të Udhëzuesit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.03-3866/1 datë 26.10.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 38-të mbajtur më 23.11.2023, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-4325/9 datë 23.11.2023 miratoi si vijon:

Aktvendim
për ndërmarrje të masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria për veprimtari botuese, marketing dhe shërbime kompjuterike NARODEN LEKAR (Mjeku popullor) SHPKNJP Shkup, botues i „Naroden lekar“, për shkeljen e kryer nga neni 14 paragrafi (1) të ligjit për media, të mënyrës që në botimin nr.591 të „Naroden lekar“ nga 11 tetori 2023, nuk është publikuar data e saktë e botimit të këtij numri, respektivisht si datë e botimit është paraqitur 8 janar 2023.

2. Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.03-3866/1 datë 26.10.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

3. URDHËROHET Shoqëria për veprimtari botuese, marketing dhe shërbime kompjuterike NARODEN LEKAR SHPKNJP Shkup, botues i „Naroden lekar“, që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi, të harmonizojë punën e tij me dispozitat nga Ligji për Media.

4. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas aktvenimit.

5. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratim llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

A r s y e t i m

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia), në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe neni 29 të Ligjit për Media (LM) është kompetente të kryejë mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të medias nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me detyrimet e neneve 6, 8, 14 dhe 15 të LM.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë – vërejtje publike në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur është kryer shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar nga Ligji i njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 29 paragrafi (2) të LM, masat që Agjencia si organ rregullator kompetent mund t'i ndërmarrë, dhe që janë të përcaktuara në LSHMAAV, zbatohen njëkohësisht dhe në rastet e shkeljes së dispozitave të LM.

Sipas nenit 14 paragrafi (1) të LM, botuesi i medias është i obliguar në vend të dukshëm për çdo bartës të përmbajtjes individualisht (për shembull kopje të medias së shtypur dhe emisioni televiziv) të sigurojë publikimin e të dhënave në vijim: emërtim dhe adresë të selisë dhe redaksisë të botuesit të medias, emrin e personit përgjegjës të botuesit të medias, emrin dhe mbiemrin e redaktorit përgjegjës, respektivisht të redaktorëve në pajtim me organizimin e brendshëm të redaksisë dhe emërtim dhe adresë të shtypshkronjës dhe datën e botimit dhe ribotimit, si dhe numrin e kopjeve, kur bëhet fjalë për media të shtypit.

Agjencia në kuadër të kompetencave ligjore, nëpërmjet Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, më 26 tetor 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative tek subjekti i mbikëqyrjes, botuesit të medias së shtypit Shoqërisë për veprimtari botuese, marketing dhe shërbime kompjuterike NARODEN LEKAR SHPKNJP Shkup, botues i „Naroden lekar“, nga ku konstatoi shkelje të nenit 14 paragrafi (1) të LM, të mënyrës që botuesi i medias së shtypit, në botimin nr.591 të „Naroden lekar“ nga 11 tetor 2023 nuk ka publikuar datën e saktë të botimit të këtij numri, respektivisht si datë e botimit është paraqitur data 8 janar 2023.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.03-3866/1 datë 26.10.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar Shoqërisë për veprimtari botuese, marketing dhe shërbime kompjuterike NARODEN LEKAR SHPKNJP Shkup, botues i „Naroden lekar“ më 27.10.2023, dërgoi Shkresë Nr. ynë PA1.03-3866/2 datë 27.10.2023, me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.03-3866/1 datë 26.10.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dërgon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga botuesi i medias së shtypit më 02.11.2023. Në afatin e paraparë, Shoqëria për veprimtari botuese, marketing dhe shërbime kompjuterike NARODEN LEKAR SHPKNJP Shkup, botues i „Naroden lekar“, nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave nga LM. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 23.11.2023, pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi që Shoqërisë për veprimtari botuese, marketing dhe shërbime kompjuterike NARODEN LEKAR SHPKNJP Shkup, botues i „Naroden lekar“, t'i shqipton masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 14 paragrafi (1) të LM, pika 3 nënparagrafi 2 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvenimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.03-3866/1 datë 26.10.2023, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LM, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 38-të mbajtur më 23.11.2023, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-4325/9 datë 23.11.2023 miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmërohet Shoqëria për veprimtari botuese, marketing dhe shërbime kompjuterike NARODEN LEKAR SHPKNJP Shkup, botues i „Naroden lekar“ dhe obligohet që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, të harmonizon punën e tij me dispozitat e LM. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas aktvenimit.

Në pajtim me nenin 24 paragrafët (1) dhe (2) të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi botuesi i medias së shtypit ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.03-3866/1 datë 26.10.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi botuesi i medias së shtypit ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.